

## INTERVISTË ME ELIZA HOXHËN

Prishtinë | Data: 18 prill, 2018

Kohëzgjatja: 54 minuta

Të pranishëm:

1. Eliza Hoxha (E intervistuar)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Aurela Kadriu:** Okej, a mundeni t'lutna me u prezantu pak shkurt për veten edhe mandej vazhdojmë me pyetje tjera, ma shumë pastaj...

**Eliza Hoxha:** (qesh) Okej, okej, une jom Eliza, Eliza Hoxha. Përndryshe, me profesion arkitekte edhe pse njerëzit shumë ma shumë më njohin në rolin e këngëtarës. Ndoshta ma shumë edhe për faktin që është profesion ma prezent në kuptimin publik. Edhe për anën tjetër që pavarësisht që kom studiu arkitekturë, punët e mia domethonë që jonë konë ma të dukshme deri vonë kanë qenë të lidhuna me muzikën, përderisa çdo vit e ma shumë muzika ma shumë është pasion edhe dashni që e ushqej edhe shpirtin tem, por e përdori edhe si platformë për me adresu çështje të ndryshme komunitare.

Edhe e përzij najherë edhe me këtë pjesën e profesionit të arkitekturës duke dal te fusha e artit në përgjithësi edhe duke i, i mishënu edhe platformat e tjera të komunikimit si instalacione. Domethonë, videon edhe muzikën në, në diçka që flet ma shumë edhe komunikon me publikë të kategoive të ndryshme. Përndryshe, te arkitektura tash sa vite mundona me gjetë domethonë një rrugë timen e cila lidhet çdo herë e ma shumë me dimenzionin social edhe me, me spektrin kulturor edhe artistik që lidhen me ngjarjet të, në qytet.

**Aurela Kadriu:** Okej, tash me të pyet direkt, çka man në mend prej protestave të marsit të vitit '98? Ju keni fotografu atëherë.

**Eliza Hoxha:** Po.

**Aurela Kadriu:** Ndoshta, nëse doni mundeni me folë pak për pjesën e fotografisë, mandej dalim te qysh është ndërlidhë aktivizmi juaj me atë që keni bo ato vite.

**Eliza Hoxha:** Po une në fakt jom, mos të thom jom nxonë në rolin e fotografës krejt rastësisht në një kohë kur andrrat e mia për me bo muzikë (qesh) kanë qenë diqysh tepër të mdhaja në një kontekst që s'të ka ofru kurgjo qysh kanë qenë të '90-tat edhe kanë mbetë në sirtar. Edhe mandej duke studiu arkitekturë, ndërkohë edhe fusha e arkitekturës osht' qasi profesioni që diqysh të lejon edhe të

mundëson me përdorë mjete të ndryshme edhe me bo sene të ndryshme që lidhen me, me arkitekturën edhe me qytetin në përgjithësi.

Fotografia ka qenë njëfarë pasioni im i fjetun edhe që unë rastësisht kam fillu me fotografu për qefin tim deri në një ditë '96-ën, kur në afërsi të banesës sime në Bregun e Diellit është vra një student i ri Armend Daci. Edhe une e kom regjistru ngjarjen edhe për fat të keq po në anën tjetër kjo ka qenë dita kur fotografitë e mia kanë dalë në publik atëherë në ballinën e javorës politike "Zëri". Duke qenë që për shkak të dinamikës së ngjarjeve njerëzit e tjerë që kanë qenë duke fotografu për "Zërin" kanë qenë në, nëpër këto ngjarjet e tjera nëpër fshatra që kanë qenë shumë ma dinamike edhe nuk kanë arritë me regjistru këtë ngjarje.

Po prej asaj kohe mandej më kanë ftu nëse du me qenë bashkëpunëtoare edhe du me fotografu, por që vetëm kur fotografitë janë cilësore ose kanë një rrëfim të caktum ato mujnë me u botu. Edhe mu më ka intrigu shumë si një e re edhe m'u ka dok si një mundësi që muj me regjistru ato se çka po ndodh përreth neve, sepse dinamike çdo herë e ma shumë duke kalu vitet, sidomos prej '96 e tutje. Duke qenë që edhe UÇK-ja kishte fillu me u përfolë për të edhe me dalë nga sfondi ma shumë në sipërfaqe.

Thjesht ngjarjet që ndodhnin ne s'kishim mundësi edhe krejt me i përcjell, sepse në vende të ndryshme kishte ngjarje të ndryshme edhe për mu ka qenë njëfarë mundësie me thonë okej të paktën çka muj me bo për vendin tem, muj me, me regjistru ato se çka po ndodh edhe me të thonë të drejtën përmes fotografisë e kom njoft Kosovën e vërtetë, e kom njoft një Kosovë që unë nuk e kom njoft duke jetu vetëm në qytet dhe në kryeqytet në Prishtinë. Nji, nji shtresim njerëzor edhe ekonomik që nuk e kom njoft veç tu jetu në Prishtinë, sepse mandej edhe përmes fotografisë m'u ka mundësu me shku me dokumentu edhe ngjarje tjera që kanë qenë jashtë Prishtinës, bashkë me gazetarë të ndryshëm të "Zërit" që kanë, kanë punu në atë kohë dhe kanë regjistru ngjarje në atë kohë.

Po ato ngjarjet e Prishtinës që lidhen me, me protesta të ndryshme që kanë qenë në forma të ndryshme në Prishtinë, po në fakt kanë kalu edhe nëpërmes *lens-it* [Ang.: thjerrëz] tim, unë kam qenë në krejt këto protesta të ndryshme që kanë qenë qoftë në bulevardin ish "Marshall Tito", sot "Nëna Terezë" apo edhe në rrugën e "Dubrovnikut" që sot me sa kujtoj titullohet "Gazmend Zajmi" ose në Velani, ose në Dragodan ku kanë qenë ambasadat, ku edhe sot vazhdojnë me qenë. Domethonë, protestat kanë qenë në shumë raste në lokacione të ndryshme dhe me mjete të ndryshme.

Kushtimisht ndër vite osht' thirrë, osht' bo thirrje publike gjatë gjithë kohës që me qenë paqësore edhe gjithmonë ka qenë grupi organizativ domethonë ose këshilli organizativ i cili osht' mundu domethonë me mbajt rendin edhe mos me dalë prej skemës si osht' mendu edhe si është ideu krejt protesta me shku prej fillimit deri në, në fund. Por jo gjithmonë ja kemi dalë, sepse ka pasë ngjarje që ka pasë aty për aty edhe kanë deviju shpesh. Domethonë, nashta najherë edhe, edhe vet protesta. Kujtoj protestat e 2 marsit, 2 mars nëse s'gaboju kanë qenë këtu te {tregon me gisht mbrapa} Radio Kosova kur me tanksa edhe me këto topat e ujit domethonë kanë fillu me...

**Aurela Kadriu:** Për cilin vit po flasim, më fal?

**Eliza Hoxha:** ‘98, ‘97-‘98 tash mos mi pyetni krejt vitet se po i miksoj edhe protestat, e nuk... memorja tash m’u kthy. Vetëm e kujtoj si ngjarje kur policia ka ndërhy, sepse me sa kujtoj ka qenë protestë e cila nuk është leju prej, prej me u mbajt, sepse megjithatë janë lajmëru protestat si të tilla edhe në polici që kanë me u mbajt edhe për derisa kanë qenë paqësore nuk kanë intervenu policia në shumë raste por në momentet kur ato kanë eskalu në diçka tjetër ose kemi qëndru ma gjatë në hapësirë sesa që ka qenë e parapame atëherë është intervenu domethonë me mjete të ndryshme. Edhe ajo ka qenë një prej protestave që ka qenë e dhunshme edhe kujtoj që prej asaj proteste e tutje në fakt protestat e tjera zakonisht kanë përfundu si të tilla.

Kisha me veçu protestën, protestën që ka qenë e nanave për shumë të rinj edhe djem që vinin prej ushtrisë në arkivole edhe qirinjtë që i kanë lonë pas përfundimit të protestës nëpër krejt bulevardin “Nëna Terezë”. E kujtoj këtë protestë për dy arsye, për këtë që e thashë edhe për një arsye tjetër sepse duke fotografu {vendos gishtin në kokë} ma kanë pasë marrë aparatën prej dorës, një person të cilin unë mandej pa vetëdije kom vrapu pas tij për me e marr aparatën mbrapa edhe pas meje e di që ka qenë dikush po se kom kuptu deri sa kom hi në stacion policor se personi ka hy në stacion policor, në stacionin që është këtu te {tregon me gisht mbrapa}, te Pallati i Rinisë “Boro dhe Ramizi”.

Edhe ka qenë Visar Kryeziu, edhe na kemi nejt aty deri sa ata na e kanë kthy domethonë aparatën, me shumë diskutime në polici. Sot kur e kujtoj për shembull atë moment thom a jom konë në terezi, që kom hy, (qesh) si me hi në gojë të ujkut, në polici. Po nuk e di ti në ato momente nuk mendon, fati që e kanë kthy se ai ka qenë civil, nuk e di edhe çka ka qenë ai personi. Po si duket ka mujt me qenë edhe një i ri që nuk ka pasë lidhje domethonë as me shërbimin policor të atëhershëm, po që ka hy aty se se ka besu që na mujm me hy aty. Edhe kjo ka qenë një prej, prej seneve që e memorizoj.

Përderisa protesta tjetër që lidhet poashtu me gratë, gratë kanë bo shumë domethonë në atë kohë, në organizimet e tyre, është protesta me bukë, e cila në mënyrë simbolike mundohet domethonë me, me, me i tregu botës që ne vujmë edhe për gjërat bazike duke qenë të rrethum edhe duke mos pasë mundësi domethonë as nivelin bazik të nevojave me plotësu. Edhe kjo ka qenë domethonë arsyeja e parë që, që protesta ka nisë si e tillë edhe pse është stopu në rrugë e sipër. Sidoqoftë, ajo që i ka shqu protestat, jo vetëm protestat e grave sepse mendoj që gratë kanë lujt një rol shumë të rëndësishëm në këtë periudhë.

Bile, bile ndoshta shpesh edhe, edhe e kanë qitë veten në pah hala ma shumë duke pretendu që policia nuk reagon kundrejt tyre me mjete të forta dhe mendoj që e kanë lujt shumë mirë edhe atë rol. E sidomos në kohën kur ne kemi qenë prezent përmes satelitit edhe në krejt mediat ndërkombëtare dhe e kemi shfrytëzu shumë atë hapsinë duke qenë prezent edhe shoqatat ndërkombëtare këtu, po edhe mediat ndërkombëtare për me i tregu botës domethonë dhe me i bo trysni botës në forma të

ndryshme përmes rezistencës edhe përmes protestës ose demonstrimit me mjete të ndryshme, por gjithmonë paqësore për me dërgu një mesazh të botës.

Edhe mendoj që krejt kjo ka pas një efekt ndër vite e vite deri në '97-tën që e thashë, jo vetëm protestat që kanë fillu me qenë pastaj më të dhunshme, por gjithçka që ka qenë domethënë në kuptimin e zhvillimit politik edhe, edhe civil në Kosovë ka pasë dinamikë tjetër. Vetëm për faktin që UÇK-ja veç ka qenë domethënë në, në skenë edhe ndërkohë që janë kriju dy vija paralele, jo vetëm në kuptimin e paralelizmit mes sërbeve edhe shqiptarëve por edhe mrenda vet komunitetit ose etnisë tonë ka pasë dy, dy rrugëtime që kanë shku paralel për me adresu çështjen e njëjtë edhe kauzën e njëjtë që ka qenë shteti i Kosovës.

Unë besoj që në krejt këtë rrëfim plot njerëz që shumë shpesh edhe nuk janë deklaruar për punën e, e UÇK-së, sot e shoh krejt ndryshe sepse domethënë mendoj që ka qenë njëfarë, njëfarë marrëveshje e heshtun, sepse mendoj që rezistenca paqësore në një moment të tillë pas '96-ës domethënë '97-'98 vetëm mo nuk kishte mundësi me shty procesin ma tutje edhe dalja në skenë e një, e një grupacioni tjetër mendoj që veç e ka, e ka, e ka prurë domethënë në pah edhe rrëfim tjetër dhe edhe një dinamikë tjetër edhe për shqiptarët e Kosovës.

**Aurela Kadriu:** Atëherë të lutem me më tregu ju keni qenë shumë e vogël në vitin '81, kur është mbajtur protesta në sallën "1 Tetori", mirëpo si fëmijë çkado që mban në mend në atë kontekst politik-social çka ka ndodh edhe qysh osht' trupëzu te ti faktikisht edhe me vazhdu, m'u ndal aty dhe vazhdojmë mandej deri në fund të '80-tave.

**Eliza Hoxha:** Unë kom qenë në klasën e parë edhe kom qenë në, në shkollën që është menjëherë këtu mbrapa Fakultetit të Arkitekturës edhe atëherë është qujt "Vladimir Nazor". Sot "Naim Frashëri"?

**Aurela Kadriu:** "Naim Frashëri".

**Eliza Hoxha:** Po, po, edhe (qesh) kemi qenë tre paralele {tregon tre gishta} që është dashtë mandej me vazhdu shkollën në "Josip Broz Tito" ose sot "Ismail Qemajli" domethënë që kemi jetu në Bregun e Diellit edhe duke qenë paralele të tilla edhe duke qenë që ende domethënë ende s'kemi kalu në atë shkollën atje. Unë zakonisht kom zbrit me prindërit e mi në mëngjes, mami ka punu në çerdhe, në çerdhen që është përball Filologjikut edhe mandej prej çerdhes kom ardh në shkollë që m'u kthy mas shkollës te mami edhe mandej me shku krejt bashkë në Bregun e Diellit.

Edhe e kujtoj që neve na kanë lëshu prej mësimi për me shku në shtëpi sepse protesta ka qenë edhe krejt kjo rruga {tregon me gisht kahjen} "Agim Ramadani" sot, atëherë ka qenë "Ramiz Sadiku", ka qenë e mbushun me njerëz edhe për mu ka qenë, edhe sot vazhdon me qenë njëfarë fotografie surreale edhe të njëjtin emocion e kom qat' fotografi e kom kështu sepse nuk e kom kuptu çka osht'. Na kanë thonë që osht' demonstrata edhe edhe edhe duhemi me dalë, me u ndërpre mësimi, duhemi me shku

në shtëpi, mundësisht mos me u sill rrugëve, po qekjo ka qenë (qesh) këshilla e mësueses, Vera Nikaj ka qenë mësuesja jeme.

Edhe... po une s'kom pasë qysh me shku se është dashtë me kalu rrugën për me shku në çerdhe edhe unë s'kom pasë qysh me kalu rrugën edhe s'kom ditë ku me kalu rrugën, sepse ka qenë krejt e bllokume me njerëz edhe e kujtoj që deri te semaforat nuk e di qysh kom mrrri në këtë rrugën {tregon me gisht kahjen} që është paralel domethonë që osht' kah ish restaurant "Pjata" këtu ose, ose "Rugova" që ka qenë edhe për me dalë sipër deri sa mo jemi gjetë me, me mamin.

Në fakt prej se e mbaj veten në mend, prej atëherë krejt çka më kujtohet sa herë kom dalë prej shpisë u konë fjalia edhe ndër vite, "Kqyr ku po shkon, me kon po folë, ku po hin, ku po shkel edhe mos mu sill rrugëve shumë" sepse pikërisht për shkak të rrethanave të paqarta. Pavarësisht që ende deri në '86-tën, mandej tek '89-ta është ajo kur prehen domethonë krejt raportet edhe relacionet edhe në kuptimin e institucioneve publike me me me zhamjen e e autonomisë së Kosovës krejt periudha e shkollës fillore domethonë ka qenë e tillë, në fakt na kemi, na i kemi gëzu {me gishta bën thonjëza} kushtimisht me thonë disa prej fryteve të socializmit më të zbehuna duke u zhba kështu krejt.

Sepse e kujtoj në atë kohë kam qenë pjesë e, pjesë e grupit të fëmijëve në radio tele... Radio Televizionin e Prishtinës. Mandej kom këndu si e vogël në "Akordet e Kosovës" në festivalin që ka pasë mbramjen e muzikës për fëmijë, mbramjen e muzikës popullore edhe zbavitëse edhe në momentin kur më ka rastisë me këndu si e rritun për herë të parë, ai ka qenë viti i fundit që janë mbajt "Akordet". Kanë vazhdu mandej edhe kështu intermezzo, kanë tentu me u mbajt nëse s'gaboje '96 edhe mandej prapë i kanë ndërpre.

Kështu që, unë i kujtoj disa mundësi të vogla që kanë qenë për neve si fëmijë në atë kohë. Ende edhe në në Qendrën e të Rive, domethonë që ka qenë edhe qendër kulturore edhe e rinisë dhe sportit domethonë "Boro dhe Ramizi". Te {me gishta bën thonjëza} "Klubi i Pionierëve" (qesh) kam qenë në Klubin e Ambasadorëve të Vegjël edhe aty kom shumë kujtime me të thonë të drejtën, sepse në njëfarë forme e kemi pasë shtetin që e kemi përfaqësu edhe jemi mundu me me përcjellë çdo ngjarje që ka ndodhë në atë shtet edhe me me me e lujt rolin domethonë në Asamblenë Gjenerale të OKB-së.

Kjo ka qenë, për mu ka qenë kështu një, një, një hapësirë ku unë jom formësu edhe edhe edhe në kuptime të tjera përtej veç asaj çka kom bo domethonë si fëmijë në kuptimin e muzikës, sepse megjithatë babi ka qenë ai që i ka punu kangët për mu edhe domethonë ai na e ka mbjell domethonë përveç talentit edhe qat' dëshirën për muzikën edhe mundësinë, a din, për me u marrë me muzikë. E krejt qeto copa, diqysh në këtë anën pozitive çka kemi mujt na me marrë prej, prej atij sistemi edhe në të njëjtën kohë protestat e vazhdueshme, konfliktet e vazhdueshme që ti shpesh edhe nuk i kupton si fëmijë po i sheh që jonë për diçka ma të madhe, sepse nuk u folke para nesh në shtëpi krejt qysh osht' situata (qesh).

**Aurela Kadriu:** Qajo, qajo po më intereson qysh është interpretu te ju qekjo?

**Eliza Hoxha:** Me thonë të drejtën gjithmonë diqysh na kanë kursy po flas për shtëpinë teme, mos me na ushqy shumë domethonë me këtë idenë e frikës, a din. Vetëm me pasë kujdes, mos me u sillë kot në qytet edhe shumë e kanë pasë të rëndësishme me kë shoqnohemi ku jemi edhe orën {prek dorën} kur duhesh m'u kthy në shtëpi (qesh), gjithmonë, gjithmonë... Po që nuk na kanë ngarku prindërit sinqerisht nuk na kanë ngarku. Pavarësisht që na kemi tentu ndoshta najherë me i kuptu senet edhe kemi bo pytje qysh zakonisht fëmiëjt dijnë edhe sot me bo për shkak të kurrështjes: pse kjo kështu e kjo ashtu.

Po që krejt këto copa diqysh jonë shumë të përzime, janë disa copa pozitive që i kujtoj domethonë prej asaj kohes sado e zorshme që ka qenë edhe që ka ndiku në formësimin tim edhe të gjeneratës tem. Po në fakt, kur e kqyr në gjeneral, na jemi njëfarë gjenerate e protestës, demonstrimit, çamjeve të mëdhaja, thymjeve, përplasjeve të mëdhaja edhe ndoshta edhe për qato edhe sot kërkesat tona edhe dëshirat tona karshi krejt çka osht' Kosova edhe qysh kish pasë mundësi me qenë Kosova ose qysh kishim pasë dëshirë na me qenë Kosova duken të jenë shumë të mëdhaja dhe idealiste. Sepse shpesh une boj hajgare me këta miqtë e mi thom, "Na si duket jemi gjenerata e fundit e idealistave në Kosovë" (qesh).

Sot i shoh edhe të rinjtë krejt ndryshe i shohin proceset edhe ndryshe menojnë edhe në raport me jetën publike edhe me paranë edhe me proceset që lidhen me ta edhe me karrierën edhe me gjithçka shumë janë ma racional edhe kanë nashta ma shpesh ideale të mëdhaja i kqyrin senet shumë ma, ma praktik a? Që nuk osht' keq ajo po që... se di une hala po mendoj që duhet me qenë pak ma idealista edhe me bo Kosovën ma të mirë. Edhe me shty qat' agjendën e madhe që na në fakt e kemi mbërri e kemi shtetëzu Kosovën po që ka shumë, shumë sene për me bo që Kosova me qenë ma e kompletume edhe ma e bukur edhe ma e mirë edhe ma e qëndrueshme domethonë si vend.

Qysh do qoftë, në krejt qeto copa të thyme të pasqyrës ku ti herë e sheh veten domethonë të plotë e herë të copëtume e të dëshpërume edhe të thyme edhe të paqëndrueshme, mendoj që gjenerata jonë ka mbërri me, me mbijetu kushtimisht me thonë në, në krejt pamundësitë që, që i ka pasë. Sidomos mandej mas të '90-tave kur neve na kanë përjashtu prej shkollave, para përjashtimit është periudha e helmimeve kur ne kemi qenë ende në shkollë atëherë kam qenë në gjimnazin "Ivo Llojla Ribar", sot "Sami Frashëri" të cilat e kanë ndiku personalitetin tonë.

Edhe ndoshta une muj me folë për veten si natyrë kam qenë gjithmonë pak ma e mbyllun ka mjaft një laps dhe një letër edhe tonë ditën kom qenë, domethonë kam vizatu s'më ka interesu ça ndodh përreth. Une sot jam shumë ma ndryshe si person, shumë ma ekspresive, me ma pak durim në sene. Najherë me reagime të shpejta, sepse ato janë shtresime që ti shpesh në idenë për me i harru edhe mos me i kujtu mo për me shku përpara edhe me i realizu senet që ti nashta s'ke mujt në kohën kur ke

qenë fëmijë ose i ri, megjithatë ato kanë metë aty edhe ato herët a vonë e qesin {ngrid duart} kryt dikun (qesh) në një formë të caktuar.

Edhe unë këtë send e kam vërejtë për shembull te vetja është njëfarë elementi që nuk e kom pa si fëmijë ose ka qenë qaty edhe... s'po di, nuk e di. Nana jem shpesh më thotë, "Shumë ke qenë ma e urtë edhe ma e përmbledhun. Tash je shumë ma e haparesht, ma dinamike" edhe, edhe ma e papërmbajtur nganjherë në raport me ato se çka s'më pëlqen ose që kish mujt me qenë ndryshe nashta veç për një kujdes ma të vogël ose për një send që mujm me mendu dy here para se me bo, po në fakt po...

**Aurela Kadriu:** A ka qenë, tash të dalim ndoshta në fillim të '90-ave, se po më pëlqen qysh po shkon qekjo ide e ndërlihdjes të identitetit tond individual me kërkesat edhe sidomos tash kur janë mbyllë shkollat, janë mbyllë institucionet ku keni qenë në atë kohë?

**Eliza Hoxha:** Na kemi qenë në njëherë [të vendosur] në shtëpinë e Sami Pejës {tregon me gisht djathtas} që është në këtë rrugën "Dubrovniku", "Gazmend Zajmi", një vit. Ndërkohë kemi qenë në rrugën "Xhemajl Ibishi", sot s'e di qysh e ka emrin ajo rrugë te hekurudha, poshtë që shkon për Makofc. Edhe mandej kemi qenë te shpija e Herticëve shkurt, sepse mandej unë e kom kry, veç e kom kry domethonë gjimnazin. Ndërkohë që në Fakultet të Arkitekturës kemi qenë në Dragodan, Arbëri sot, në disa shtëpi. Nuk i di me emra pronarët, njoni prej pronarëve më kujtohet, sepse osh't baba i një shoqës teme, Zana Bajramit, Bahri Bajrami nëse s'gaboj. Edhe dy pronarë të tjerë të shtëpive që kanë qenë aty afër, në të njëjtën rrugë, domethonë një distancë 50 metra, njëqind metra ndërmjet.

Kështu që, praktikisht me thonë, ose kështu shumë thjeshtë, unë krejt studimet e mija i kom përfundu në shkolla shpija. Kom absolut në atë periudhë, po fakultetin e kom kry mas luftës, domethonë kom diplomu mas luftës. Për shumë arsye, e para që hmm, çka është me rëndësi pse kom shku në arkitekturë është krejt e paqartë për mu me thonë të drejtën edhe sot (qesh). Hala munona me gjetë ku osh't vendi jem në arkitekturë edhe si duket qekjo është arsyeja pse provoj sene shumë edhe, edhe mundona me i kombinu me krejt ato çka kom qef me bo.

Ka qenë e pamundun me shku në muzikë, unë kam qenë e lidhun shumë me muzikën dhe m'u ka dok shumë absurd në krejt qat' periudhë çka kom unë me bo me muzikë në krejt këtë kontekst që kurgjo s'të ofron. Edhe plus që pata ngel pa e përfundu shkollën e ultë të muzikës, se e pata lonë në gjysë (qesh) edhe mu dukte vetja e pabarabartë me tjerët që mujnë me konkuru në akademi, duke mos qenë e përgaditur mirë. Duke qenë një person që kom vizatu shumë si si fëmijë edhe ka qenë njona prej prej seneve që e kom bo me shumë dashni, kom shku në arkitekturë. Ma mirë me thonë kështu qorrazi, pa e ditë se çka më pret edhe çka munet me m'ofru ose ku muj me gjetë veten edhe këtë send e kom kuptu shumë vonë mandej, se ku unë muj me bo diçka në arkitekturë ose çka është për mu krejt ky profesion.



Nuk e kom gjetë gjatë studimeve në sistemin paralel. Kemi qenë shumë të mangët në gjithçka. Imagjini kur ti je në një dhomë pak më të madhe se kjo [i referohet dhomës së intervistës], ku shumica e njerëzve shpesh ulen ose në tokë ose rrinë në komë edhe ku s'ki kurgjo, as libra, as kompjuter, as kurgjo. Edhe krejt çka kemi mësu ka qenë domethonë prej shënimeve ose disa skriptave që ish ose profesorët tanë, ose ish profesorët që kanë qenë ma herët që i kanë lonë për asistentët e tyre që mandej janë shndërru në profesorët tanë. Sepse fakulteti i arkitekturës në atë kohë para se me u shkëput prej sistemit publik, megjithatë ka pasë profesorë prej Sarajevës, Shkupit, Beogradit edhe Zagrebit për faktin që është themelur shumë vonë në vitin '78 edhe nuk ka pasë resurse të mjaftueshme njerëzore lokale që me u mbajt mësimi.

Në momentin kur është shkëputë [nga Jugosllavia] asistentët që kanë qenë, domethonë që kanë asistuar në landët e profesorëve që kanë ardhë si profesorë mysafirë prej fakulteteve tjera e kanë marr domethonë landën në dorë. Edhe ne kemi mbijetuar domethonë me këto skripta dhe këto, këto shënime që i kemi marr, të privum prej, prej, prej krejt qasjes në informata tjera ose osht' ni sen edhe ironik që edhe ato libra që i kemi pasë kanë qenë krejt sërabisht (qesh). Edhe sot kur e kujtoj thom ok kemi dalë prej shkollave se s'kemi dashtë me mësu sërabisht, a në fakt kemi qenë në sistem paralel, po krejt çka kemi lexu ka qenë sërabisht. Se s'ki pasë libra në shqip edhe ajo që është sot për me të ardh keq osht', se edhe sot fakulteti jonë me pasë mungesë të literaturës në gjuhën shqipe, sepse pak ose aspak libra jonë përkthyer domethonë që i shërbejnë domethonë kurrikulës.

**Aurela Kadriu:** A ka tendencë ma vazhdu me i shfrytëzuar librat?

**Eliza Hoxha:** Jo, te të rinjtë, jo të rinjtë, sepse nuk e dijnë gjuhën serbe. Por unë mendoj që është shumë me randësi, domethonë për me i prodhu librat në gjuhën shqipe, pavarësisht që gjeneratat e reja tentojnë gjithë me ditë anglishten. Unë besoj megjithatë që ne si shtet duke respektu Kartën e të Drejtave të Njeriut, domethonë e drejta elementare është me u shkollu në gjuhën tonde. Ai që ka synim me u zhvillu ma shumë sot, anglishtja është domosdoshmëri, por megjithatë ne jemi të obligum ose duhemi me qenë të obligum si shkollë me ju ofru edhe literaturën bazike në gjuhën shqipe. Po kcej prej kohës në kohë, po a din, po e mendoj kështu si proces.

Në anën tjetër, unë tek mas luftës e kom kuptu sa s'di në profesionin tem (qesh) edhe kur jom shku në Belgjikë në studime të magistraturës, që kanë qenë domethonë mas diplomës, domethonë ka qenë ma shumë specializim muj me thonë. Aty e kom kuptu, e para se çka kom qef me bo, edhe ku une muj noshta me bo diçka, e kom gjetë vetën a, qatë pikën teme, pozicionin tem... Edhe sa na ka lonë neve të mangët sistemi paralel, jo veç gjeneratën tonë, po disa gjenerata.

Kështu që, ajo periudhë i ka, prapë se prapë, i ka anët e mira, në kuptimin e mobilizimit social, në kuptimin e vullnetarizmit, aktivizmit, edhe krijimit të njëfarë platforme të përgjithshme, ku mo kërkush s'ka shiku se kujt duhet me i ndihmu edhe pse. As nuk është dashtë me pytë dy herë, nëse

osht' dashtë me bo diçka, duhet me bo edhe u kry. Por në fakt, kur e sheh me një distancë sot e kupton që shumë të meta që jonë në sistemin e edukimit sot, tu e përfshi edhe Universitetin e Prishtinës.

Shumë mangësi që ne i kemi sot ose, ose ngritjet tona profesionale që i kemi bo me vonesë, i kemi bo sepse për dhjetë vjet ne s'kemi pasë qasje domethonë, edhe mundësi për me u shkollu si duhet ose edhe me u avancu domethonë në nivelet e tjera të edukimit në, domethonë, në doktoraturë ose të tjerat. Kështu që, krejt jemi, krejt, gjenerata jeme këto i kemi bo dhjetë vjet ma vonë, me dhjetë vjet të shtyme. Ka të tillë që janë dorëzu. Unë kom plot shokë edhe shoqe që bojnë krejt diçka tjetër edhe nuk kanë tentu mo edhe njiherë me i hi këtij procesi. Por ka edhe të tjerë si puna jem që krejt jeta i shkon në shkollë (qesh) edhe kanë vazhdu domethonë ose me bo një specializim shtesë ose doktoraturë edhe edhe me u përpjekë domethonë me dhonë kontributin e vet në profesionin që që e kanë përzgjedh.

Sot prapë po thom, me distancë kohore e them që nuk ka lidhje sepse ndërrimi i pozicionit ose edhe i profesionit osht' sen shumë i natyrshëm a. Jo vetëm kushte problematike ose, ose lufte ose, ose kushte të paqëndrueshme, sepse idnamika e jetës është krejt tjetër edhe najhere nuk ja qëllojmë herën e parë kur e zgjedhim profesionin. Sot ka shumë raste, për shembull muj mi përmen veç dy arkitektave që... Rem Koolhaas<sup>1</sup> që ka qenë, ka shkru skenare edhe ka qenë gazetar edhe sot osht' prej arkitektave ma të njoftun ose nëse s'gaboj Libeskind<sup>2</sup> i cili ka qenë çellist edhe në moshë shumë të shtyme ka vendos me studiu arkitekturën edhe osht' arkitekt shumë i njoftun sot (qesh).

Domethonë, nuk osht' marre edhe nuk osht' problem nëse në një moment e kuptojmë që s'jemi për qat' profesion ose ose gjejmë një profesion tjetër që na jep shumë ma shumë edhe në kuptimin shpirtënor, po nashta edhe material pse jo, a, se nuk e dijmë. Edhe për qato po kom qef me thonë se ndoshta edhe i kisha inkuraju të rinjtë që me rimendu shpesh gjatë jetës se a janë tu e bo punën që e dojnë edhe a osht' ai profesioni që ata e kanë zgjedh i vërteti për ta.

## Pjesa e Dytë

**Eliza Hoxha:** Kështu që, të '90-at jonë për mu njëfarë periudhe shumë interesante në krejt dimensionet e mundshme. Në përplasjet e mrenshme që i kemi pasë që kurrë s'i kemi shpërfaq në, në platformat e tjera, kanë qenë të heshtuna sepse ka pasë grupacione të ndryshme që për qëllimin e njejtë kanë bo sene të ndryshme ose kanë menu ndryshe, po që...

**Aurela Kadriu:** Qysh po mendon...

<sup>1</sup> Remment Lucas Koolhaas (1944) është një arkitekt holandez, teoricien arkitektural, urbanist dhe Profesor në Praktikën e Arkitekturës dhe Dizajnit Urban në Shkollën e Dizajnit në Universitetin e Harvardit.

<sup>2</sup> Daniel Libeskind (1946) është një arkitekt, artist, profesor dhe dizenjator, polako-amerikan. Libeskind themeloi Studio Daniel Libeskind në vitin 1989 me gruan e tij, Nina, dhe është arkitekti kryesor i atij objekti.

**Eliza Hoxha:** Po gjithmonë ka qenë për shembull rezistenca paqësore ka qenë një vijë, po gjithmonë ka qenë edhe edhe edhe vija tjetër domethonë ma rrebele, ma... paralel ka qenë po ka qenë si me thonë *undercover* [anglisht - i fshehtë], domethonë nëntokë a, LKÇK-ja, LPK-ja, a din mandej krejt ajo u bo UÇK-ja, s'po di qysh me thonë. Gjithmonë ka qenë edhe një lëvizje që nuk e ka mendu rrugën e njejtë po mendoj që për kauzën e madhe këto përplasje janë amortizu deri sa ka ardhë një moment tjetër kur ajo vijë nuk ka rezultu mo me e shty procesin tutje dhe u dashtë me ndodh diçka tjetër. Veç po du me kallxu qet' paralelizmin që ka ekzistuar gjithmonë edhe mrena vet shqiptarëve. Mandej e kemi pasë "Tre përqindëshin", mandej e kemi pasë edhe një fond "Vendlindja Thërret", gjithmonë i kemi pasë ka dy, dy vija a, po që megjithatë nuk janë përplasë shumë publikisht, veç për faktin që ka qenë qëllimi i madh a, qëllimi i madh.

**Aurela Kadriu:** Diçka ma specifike, cila prej këtyne, tash qysh me i qujt, jo timelines po, po në fakt janë timelines, ka qenë ma e afërt për ty, ku e ke ni ti qat' farë përplasje ose qat' kohezion të paralelizmit?

**Eliza Hoxha:** Po flet, që po flas qeto në kuadër të shqiptarëve?

**Aurela Kadriu:** Qoftë për përqindëshin, qoftë për...

**Eliza Hoxha:** Ne, unë po të thom, na kemi qenë të ri edhe për mu, për mu çdo send që ka pasë të boj me Kosovën ka qenë kauzë {ngrit grushtin lart}, a edhe për mu ka qenë fare pak e rëndësishme. Unë prej momentit kur e kom kap aparatën në dorë edhe kom fillu me punu domethonë si fotografe, për mu qajo ka qenë instrumenti edhe mjeti jem edhe kontributi jem, arma jem për me bo edhe për me dhonë diçka për Kosovë. Edhe une nuk e kam pasë hiç problem se cili grupacion don me adresu diçka, përderisa ka të boj me qat' çështjen madhore. As sot nuk e kom problem a, sepse mendoj që bukuria e proceseve qëndron pikërisht në shumëllojshmërinë edhe të mendimeve, pavarësisht sa përplasen ato.

Kur qëllimi është i madh edhe është fisnik, na duhemi me qenë të sinqertë me veten. Mjetet mujnë me qenë shpeshherë të ndryshme, po kur i shërbejnë një qëllimi, mendoj që krejt arsyetohen a. Përderisa nuk e përmbysin njona-tjetrën (buzëqesh), e në këtë rast nuk e kemi përmbys a. Domethonë kemi shku, kemi kapërcy, a, për me e çu qat' qëllimin e madh përpara ose për me mrrri qat' qëllimin e madh që nuk është e njejtë shpeshherë sot në Kosovën e mas luftës. Na sot jemi në gjendje najherë këtë shumëllojshmëri mendimesh qofshin politike ose sociale ose të tjera me me me me me përmbys procese të mëdhaja për ego të vogla ose ose ose sende të vogla.

Kjo është ajo që më brengos mu për shembull sot në raport me, me kohën e atëhershme ose, ose a duhet me ja bo naj pyetje na vetes në pasqyre sot njëherë e përgjithmonë që gjithmonë duhet me pasë një armik që na me u bo bashkë pavarësisht të ndryshmeve edhe me qëndru bashkë në një mozaik që na bjen tonëve mundësi me nejt vetja edhe me kontribu qasaj fotografisë së madhe a duhemi domethonë me përmbys njoni-tjetrin vetëm për interesat e vogla edhe për, për, për egot personale.

Edhe ky është një moment që edhe një pyetje që kisha pasë qef njerëzit me fillu me ja bo vetes në Kosovën e mas luftës, sepse unë besoj në të ndryshme, unë besoj që bukuria jo veç e një vendi po edhe e proceseve qëndron pikërisht aty. Përndryshe, ishim monoton nëse ishim krejt të njëjtë. Njerëzit lindin të veçantë, lindin unik, secili në mënyrën e vet. Edhe ne duhemi me fillu me e respektu të ndryshmen edhe me vlerësu të ndryshmen, por që me u bo bashkë për qëllimet që i kemi në proceset tona edhe të jetës edhe personale, por edhe kolektive sidomos, se aty vjen në shprehje mandej qajo përplasja.

**Aurela Kadriu:** Qysh ka qenë periudha e erës tonde si fotografe, kur ka nisë, kur ka... kushtimisht përfundu?

**Eliza Hoxha:** Po, e thashë pak ma herët që ka qenë njëfarë arme e jemja, domethonë figuativisht. Mandej u bo një armë e jemja edhe kom thonë, okej, une s'kom shku në luftë me kontribu, une edhe s'kom qenë mandej pjesë e çdo proteste si akter, sepse kom fotografu. Kështu që, qekjo osht' qajo çka une muj me dhonë edhe me bo për Kosovën, duke, duke e shënu çdo moment, po edhe duke lonë njëfarë historie të vogël {afro gishtat} në këtë historinë e madhe. Mu me thonë të drejtën më ka formësu shumë si njeri edhe muj me thonë që në krejt luhatjet që mujmë me i pasë ne si të ri a, jo vetëm të qenit vajzë (qesh) ku na i kemi do ëndrra tona edhe, edhe synon domethonë ato ëndrrat me xixëllima kur je e re. E sidomos për faktin që unë si fëmijë kom këndu edhe mandej e kom pasë gjithmonë në mendje dhe në ide që ko me këndu edhe kur të rritna e ajo u nal në gjysë.

Domethonë, fotografia më ka ndihmu mandej me pa ato që thashë ma herët, Kosovën e vërtetë po edhe me ju kthy vetës edhe me ju kthy vendit tem shumë ma shumë. Mos mi harro ondrat a... po me pa edhe shumë shumë fëmijë edhe të rinjë edhe të reja që nuk kanë nashta as mundësi me ëndërru ma shumë sepse luftojnë çdo ditë për sendet bazike edhe ti fillon mandej me qenë shumë ma i mirëkuptushëm për shumë sene që të ka dhonë jeta ose që të ka ofru jeta edhe për shumë mundësi që t'u kanë dhonë veç për faktin që ke lind në qytet. Ndoshta edhe fillon me u bo ma i hapun edhe me zgjanu zemrën edhe unë po thom aparati ose syni i tretë qysh i kanë thonë gjithë, ka qenë syni që une e kom njoft Kosovën e vërtetë edhe jom shumë e lumtur për atë sen edhe më ka ndihmu. Jo, s'po thom ndoshta edhe më ka ndihmu, por thjesht mendoj që më ka bo njeri ma të mirë. Në kuptimin që jo që kam qenë njeri i keq s'po di tash (qesh), po njeri ma të mirë në kuptimin e përgjegjësisë sociale edhe edhe idesë...

**Aurela Kadriu:** Qytetarisë domethonë.

**Eliza Hoxha:** Po, po, për gjithçka edhe ajo ka mbet në mu pavarësisht që unë kom fotografu deri në fund të luftës ndërkohë për te "Zëri" kom punu një kohë edhe për fondacionin SOROS para luftës, deri në vitin 2000 pas luftës, i kom regjistru ngjarjet edhe programet që ata i kanë pasë në atë kohë për Kosovën. Ndërkohë që masi e kom finalizu albumin tem të parë edhe qat' ondrën që e kom pasë prej fëmijërisë edhe ju kom kthy studimeve që kanë metë kështu zhag (qesh) duke i ndërpre kohë mas

kohe. Thjesht nuk e kom pa mo të arsyshme për me punu dikun për me bo fotografi, sepse jom mundu m'u fokusu mandej me i kry studimet edhe me u fokusu te arhitektura.

Edhe ndërkohë që albumi i cili u kry me shumë pasion edhe me njëfarë sinqeriteti maksimal veç sa me realizu ondrren, në fakt ka rezultu me qenë tepër i suksesshëm. Edhe mandej ka qenë tepër dinamike krejt ajo periudhë për mu në kuptimin e pozicionit të këngëtarës edhe ka qenë pamundur me i bo tre sene në të njejtën kohë. Kështu që, aparati ka mbet ma shumë në në në sfond edhe sekreti jem ma i madhi nëse foli për punën e aparatit mandej ka qenë kur unë u dashtë me dalë në anën tjetër, si sot që jom qitu edhe me më fotografu dikush tjetër me më thonë {imiton poza për fotografim} “Bon kështu çoje dorën, bon ashtu, bon kështu”.

O Zot (qesh) katastrof ky sen, qysh mujn me duru njerëzit me u ngri kështu para aparatit edhe kom pasë tepër tepër zor me fotografitë që janë në albumin e parë, hiç s'jom e lumtur me to. Katastrofë s'më pëlqejnë. Ka qenë tepër e zorshme ndërrimi i pozicionit prej anej - knej edhe hala më përcjell ky problem, sepse edhe kur xhiroj najhere edhe pse sot janë shumë ma të pakta këto xhirimet e klipave edhe këto që lidhen me muzikën une e kom patjetër me shku në montazh me nejt bashkë me me produksionin deri sa të kryhet montazha, se duhna me pa tash në anën tjetër krejt çka ka (qesh). Më ka metë nuk muj. Mënyra për shembull une qysh e mendoj kur xhirojmë, kur e shoh nuk osht' qashtu a, se e kornizoj ndryshe në kry. Më ka lonë me defekte, a.

Po s'e di, osht' diçka që e pëlqej, vazhdoj me bo, e boj veç për qefin tem edhe këtë pjesë jom mundu mandej e kom lidh me arkitekturë. Për shembull këto foto këtu që jonë {tregon me gisht para vetes}, jonë foto që unë i boj në kuptimin arkitektonik që unë i lidhi me njëfarë poetike të hapsinës, detaje të vogla, sende që unë i interpretoj mandej në mënyra të tjera, por që lidhen me arkitekturën ose me elemente arkitektonike. Kështu që, krejt senet pavarësisht që në një moment të caktum njena ka qenë primare, tjetra sekondare, mandej tjetra e ka marr rolin kryesor, tjetra ka met në sfond, në këto vitet e fundit më kanë shërby si platforma për me i bo bashkë edhe për me kallxu rrëfimin tem qoftë si Elizë çka menoj për këtë vend, qoftë edhe për zonat [zërat] e tjerë që janë të padëgjushëm, si rasti i grave të dhunume, si rasti i i personave të, i familjarëve të personave të pagjetur.

Dy projekte të mëdhaja që unë i kom pasë në raport me këto dy kategori që vijnë edhe me fotografi edhe me instalacione, me multimedia domethonë në përgjithësi edhe me video edhe me muzikë. Edhe ky ka qenë mendoj momenti ma i rëndësishëm në jetën tem kur unë kom fillu, jo mo me i përjashtu njona-tjetrën, por me i mishënu edhe me u ndi mirë që i boj. S'ka rëndësi edhe s'ka lidhje a jonë ma së mirti a, mu më japin shumë kënaqësi edhe më japin mundësi me komuniku me njerëzit e tjerë edhe me thonë ato që menoj në forma të ndryshme.

Ka qenë një periudhë e dilemave, se nerëzit kanë kërku prej meje me u përcaktu a jam këngëtare, a jam arkitekthe, a jom fotografe. Edhe kjo idea e përcaktimit edhe e përjashtimit është diçka që mu më ka tmerru edhe atëherë, vazhdon me më tmerru, po jo mo personalisht, vazhdon me më tmerru në

kuptimin e qasaj që i shohin njerëzit e zhveshur, a din veç me një send edhe nuk muneshe me i bo dy edhe me i përfaqësu dy, dy anë të tua ose dy mundësi komunikimi. Kështu që, po aparati vazhdon me qenë një dashuri e imja. Është e mahnitshme sa shumë ma qetëson shpirtin kur e kom me veti.

Edhe kom lonë shumë sene pa bo në jetë, për shembull në kutpimin e disa bjeshkëve që s'kom shku hala veç pse (qesh) s'kom mbrri hala me ble një aparat digjital me film, po osht' shumë e kushtushme. Unë i kom dy me filma që jonë në shpi të vjetër, po që nuk i përdori mo kështu që po pres (qesh) për me bo mandej rrugëtimin e radhës edhe me ju rikthy. Pot osht' krejt punë qefi, nuk osht' mo punë, nuk osht' mo mision, osht' pasion. Në kohën e '90-tave ka qenë mision, o shëndërru në mision. Ka nis krejt rastësisht, po në fakt ka qenë mision që kudo që kom shku me pasë aparat, se s'i dihet edhe mundet me ndodh diçka edhe me regjistru çkado që ndodhë.

Sot jom shumë e lumtur që e kom një fond të fotografive i cili nuk është komplet sepse duke qenë e punësime në "Zëri" është dashtë me i dorëzu filmat në "Zëri" kur jonë botu fotografitë. Një pjesë e tyre ka mbetë në "Zëri". Duke qenë që është dashtë me u dorëzu kur janë botu fotografitë, përdërisa një pjesë tjetër ka qenë në shtëpinë time, te prindërit e mi për fat të mirë ato ende janë. Përdërisa filmat ose negativat që kanë qenë në "Zëri" disa prej tyre janë dëmtu kur policia në atë kohë, sidomos në kohën kur na kemi qenë refugjatë janë demolu këto hapësinat e sistemit paralel edhe redaksitë e shumta, sepse më duket kanë kërku informata edhe edhe dokumente të caktume e janë dëmtu një pjesë e filmave. Një pjesë tjetër kanë ngelë, domethonë janë filma të përzimë të të tre fotografëve që kanë qenë në "Zëri" dhe në pamundësi me i marr dhe duke prit me i marr doemthonë unë edhe nuk ju kom rikthy asnjherë fotove që i kom pasë në shtëpi.

Tek vonë rishtazi në në dhjetor të vitit të kalum [2017], unë kom vendos me bo një ekspozitë të vogël me disa prej fotografive të viteve të '90-a edhe ka qenë njëfarë momenti shumë interesant me pa nejrëz që sot i kom miq ose sot janë akterë të rëndësishëm të jetës publike, qoftë në institucione ose në shoqërinë civile, kur ti i sheh nëpër fotografi tua. Edhe me më pasë pyet najkush kisha thonë, "Jo more çfarti s'kom une fotografi të Edi Shukriut ose të Eli Krasniqit ose... dikujt tjetër a". Tek kur kom fillu me i pa mandej ti e kupton që aha, me një distancë kohore fillon me i pa krejt ndryshe. Mandej edhe ato marrin njëfarë rëndësie tjetër, njëfarë peshe tjetër, një kuptim tjetër edhe sado pak që jonë mendoj që megjithatë jam shumë e pasur që e kom deri diku të regjistrome një pjesë të '90-ave në, në filmat e mi.

**Aurela Kadriu:** Nëse mundeni me u ndal shkurtimisht për këtë periudhë për marshin për Drenicë, specifikat e asaj, qysh ka nis, qysh ke marr vesh që ka me ndodh marshi, qysh u plasu qajo informatë?

**Eliza Hoxha:** Une e kom marr vesh për marshin si çdo send që ka ndodh domethonë në atë kohë. Mediat e kanë ditë edhe unë kom qenë duke punu në "Zëri" edhe ne e kemi pasë gjithmonë, s'po thom obligim a, se s'të ka shty kërkush me zor me dalë përveç atynve që kanë qenë të rregullt të punësime aty, bashkëpunëtorë. Ne kemi pasë mundësinë me dalë aty ose mos me dalë, po unë kom dal *nonstop* [pa ndal]. Po duke qenë që kemi qenë tre persona, jemi pozicionu në mënyra të ndryshme.

E kujtoj që fillimisht kemi qenë në rrugën, në bulevardin {tregon kahjen me gisht} domethonë “Nëna Terezë”, mandej rrugëtimi ka qenë kah Arbëria nëse s’gabo. Edhe i kemi pasë pozitat e caktume secili prej nesh se ku kemi me regjistru ngjarjen që mos me na ikë kurgjo, sepse idea ka qenë që mos me qenë në vendin e njejtë a, që dinamikën e komplet ngjarjes me përcjellë. Për shembull, unë nuk kom fotografi atje ku jonë stopu gratë, që është ndal domethonë marshi. Kom fotografi kur jonë nisë, kur ka nisë marshi dhe rrugëtimi mandej kur vjen prej... sepse janë stopu mandej te Hotel Bozhuri, ka qenë një kordon i policisë nuk i ka leju domethonë gratë me kalu dhe mandej janë kthy kah rruga që vjen te OSBE-ja që del, ku është objekti sot, për me, me kalu domethonë në anën tjetër.

Unë kam prej asaj pjese domethonë të regjistrueme fotografi, ngjarja ka qenë shumë e rregullt, unë po thom kanë qenë gjithmonë këta kujdestarët e protestës që e kanë pasë ka një shirit {sikur lidh diçka në krah} të lidhun. Çdo protestë ka qenë super mirë e organizume edhe kujdestarët kanë qenë tepër tepër të kujdesshëm a, edhe jo rastësisht ju thojnë kujdestarë (qesh). Për faktin që për gjëra të vogla ka mujt çdo protestë domethonë me eskalu ose m’u provoku prej dikujt prej jashtë që ose s’ka menu njisoj si ti, ose e ka pasë të rëndësishme me nxit a, që ti me qenë në sy të mediave, në sy të botës si dikush që po nxit dhunë ose, ose, ose problem. Kështu që, protesta ka shku në rregull, ka qenë paqësore, ka qenë madhështore kushtimisht me thonë.

Sidomos kur sheh ti momente të regjistrueme, sidomos në fotografi po edhe aty kur je prezent, kur përballja mes kordonit të policisë me mjete të forta {sikur mban armë në duar}, me armë dhe me një grupacion domethonë rresht të gjatë të grave me bukë në dorë {ngrid dorën}, shumë ironike si situatë a, domethonë kur e shikon. Kështu që, ma shumë nuk muj me, me, me tregu se megjithatë unë kam qenë njëfarë akteri aktiv edhe pasiv nëse foli për protesta, se s’kom qenë aktive në kuptimin mrenda me ditë krejt çfarë emocioni ka qenë, kom qenë gjithmonë prej {ngrid dy duart para vetes} anës tjetër, domethonë që është dashtë me i regjistru. Po po flas si imazh edhe i regjistruem në kokë edhe kështu në fotografi disa që i kom.

Megjithatë edhe sot i kujtoj si një prej protestave që ka qenë sa madhështore qaq edhe ironike në të njejtën kohë kur e sheh. Osh’t e mahnitshme sepse mesazhi ka qenë i rëndësishëm edhe në këtë pikë mendoj që shqiptarët e Kosovës kanë qenë hiper-kreativ, po edhe vazhdojnë sot me qenë kreativ. Nashta prej, prej duke qenë të privum prej gjanave elementare, shpesh edhe prej, prej mungesës së hapësirës me shpreh veten, mandej si duket edhe shkencërisht është e vërtetume që njerëzit bile edhe artistat bohën shumë kreativ në rrethana të paqëndrushme dhe të komplikushme edhe edhe të zorshme për jetë.

Por kisha pasë qef me na përcjell ky kreativitet edhe në kushte paqeje edhe pse Kosova në fakt në këtë kontekst edhe në këtë pikë mendoj që shquhet a, nëse flasim për, për aspektin e kreativitetit edhe qetij softverit të qytetit edhe mobilizimit edhe edhe edhe aktivizmit a. Por ajo që kisha pasë qef me adresu krejt në fund është që neve na ka shpëtua ideja e aktivizmit edhe e mobilizimit social në vitet e ‘90-a, mendoj që sot osht’ e domosdoshme që të ketë më shumë aktivizëm edhe mobilizim, jo vetëm kur

kemi problem edhe jo vetëm kur kemi nevojë por edhe kur dëshirojmë me adresu çështje për me përmirësu edhe për me, me ngrit debate të reja ose agjenda të reja për neve edhe për Kosovën.

**Aurela Kadriu:** Veç me ndërlidh edhe këtë pjesë, pak si të fundit, a e kishit ndihmu ndoshta... qysh, qysh prezentohet sot, qysh diskutohet sot nëse diskutohet për krejt protestat që kanë ndodh '80, '90 po këtë rast veç jemi të fokusum te marshi i Drenicës, specifikisht marshi për Drenicë, domethonë marshi me bukë në dorë për Drenicë, po mendoj përveç gjeneratës të juj që nashta keni qenë ma shumë rini, gjeneratat e reja, gjeneratat nashta pak ma të ri se unë, a ka, a ka diskutime për këtë protestë?

**Eliza Hoxha:** Shumë pak, shumë pak mos të thom aspak edhe përtej disa akterëve që me xhelozitë kështu, në kuptimin e mirë të fjalës janë mundu me e rikthyer në agjendë idenë se çka kemi kalu, forcën e protestës a, edhe demonstrimit pakënaqësisë, rëndësinë e saj a, sepse e thash edhe ma herët jo vetëm kur jemi në rolin e viktimës po edhe sot mujm me demonstru ato se çka ne dojmë dhe menojmë a, përmes mjeteve të ndryshme paqësore po që me i mbri qëllimet tona domethonë edhe me e përmirësu jetën këtu. Shumë pak folet për të '90-at në përgjithësi. Kanë fillu të them kështu me gjuhën e popullit me çapurit (qesh) aty-këtu ka lëvizje, ka lëvizje, ka njerëz që kanë shkru punime shkencore domethonë për këtë periudhë. Po që këto punime shkencore shpesh po janë veç për një publik të vogël, të limitum.

Mandej nuk po janë prezente për këtë publikun e gjanë që është jashtë e sidomos për të rinjtë pak flitet, po flas edhe këtu në fakultet a, se çka ka ndodh në ato vite në kuptimin jo veç arkitektonik po a, edhe urbanistik edhe social sepse nuk mujnë me u shkoqit. Për shembull, nëse flasim për dimensionin social për protestat ato kanë ndodh në qytet nuk munesh me shkoqit kontekstin hapësinor edhe vendin sepse është shumë i rëndësishëm. Por megjithatë ka fillu a, edhe shpyqyr që ka fillu, ndoshta osht' dashtë me qenë një distancë kohore, ndoshta përnime ka qenë qekjo energjia po flas e krejt grupacioneve që i kemi përjetu direkt këto ngjarje që jo mi harro kushtimisht sa me pa përpara, me vrapu, m'i realizu krejt senet që na s'kemi mujt edhe kemi qenë të privum për me pasë qasjen tonë edhe mandej në qet', në qet' vrapim me realizu veten edhe dëshirat tona të porealizume të '90-ave kushtimisht kemi harro me tregu rrëfimin për të '90-at.

E sot me të thonë të drejtën edhe tash sa po flasim ka shumë kështu vrima të zeza edhe në vet ato se çka kom bo une për shembull për veti edhe ku kam qenë akter edhe najherë kur folim, sepse aktualisht jemi duke punu edhe për bienalen e Venedikut edhe temën e kemi për të '90-at. E shoh që edhe me njerëzit e klasës edhe me shokët e shoqet edhe me njerëzit që kanë qenë pjesë e, e rrugëtimit tem domethonë në një pikë ose në një tjetër, për të njejtën ngjarje kemi majt mend sene të ndryshme edhe naj send për shembull mu s'më bjen në mend hiç, sepse si duket truni ka memorizu çka ka dashtë ose çka na, ose çka unë kom dashtë ose çka të ka mbet ty në memorje ose të ka bo problem ma shumë ose të ka metë si emocion i ngulitun ma shumë.

Nuk e di osht' shumë interesant, domethonë këtë debat me bo edhe mrena vet njerëzve që kanë qenë akter në një ngjarje për mi pa të ndryshmet edhe mi bo bashkë për me kompletu qat' rrëfimin për



ngjarjen e sidomos mandej kur folim për ngjarje të ndryshme që na kemi qenë në pozita të ndryshme edhe dikun kena qenë spektatorë, dikun kemi qenë aktorë, kemi marrë pjesë direkt, dikun veç vëzhgues a, dikun kontribues, dikun organizatorë. Edhe në kuadër të qatyne roleve mandej prapë kemi rrëfime dhe perspektiva të ndryshme. Po mendoj që ka ardhë koha që na si komunitet edhe si shtet besa-besa me fillu me legjitimu historinë e re që është historia e të '90-ave.

Nuk është histori veç lufta që ka ndodh si akt është komplet dhjetë vjeçari i të '90-ave edhe akterët e ndryshëm kanë rol edhe kanë meritë të caktuar në ato se çka kemi kalu edhe në ato se çka është Kosova. Une kom thonë në një rast tjetër edhe vazhdoj me e mendu edhe me e thonë që Kosova nuk ka lind në 2008-tën si shtet, Kosova është përcaktu për shtetësinë e saj kur ne kemi dalë prej institucioneve ose jemi përjashtu edhe kemi ndërtu sistem paralel. I mirë, i keq, me krejt të metat që i ka ai sistem e ka kriju bazën për Kosovën sot me krejt të metat që i ka. Shteti është proces edhe unë besoj që në këtë proces ne duhemi krejt me kontribu e jo veç me prit, secili në mënyrën e vet për me i bo qato kockat bashkë edhe me e bo Kosovën shtet funksional.

Përndryshe, nëse ne nuk i legjitimojmë edhe nëse gjenerata si puna jonë ose e prindërve tanë që kanë krejt një rrëfim tjetër a, ose fëmijëve që kanë qenë në të '90-at që as nuk e kujtojnë, ata kanë luft bashkë (qesh), krejt kanë tjetër rrëfim për të '90-at. Nëse ne nuk e tregojmë këtë rrëfim edhe nuk e legjitimojmë si histori të Kosovës edhe nuk e muzeojmë dikun, mendoj që ma shumë se që kemi m'i bo dëm vetes nuk, nuk i bojmë dëm kërkujt. Kështu që, ka ardhë koha që njerëzit që kanë materiale të ndryshme, fotografi, video, rrëfime të caktuara që kanë nda ose përjetimet e caktuara që veç [tregon në drejtim të kamerës] kjo osht' njo prej tyre, ose një prej metodave që ju veç po e praktikoni mujnë me e sjell një, një rrëfim kolektiv të mahnitshëm dhe shumë specifik edhe shumë unik të shqiptarëve të Kosovës dhe mbijetesës së tyre edhe rrugëtimit tyre për shtetin e Kosovës që ka nis në vitet e '90-a.

**Aurela Kadriu:** Faleminderit shumë!